

“DIGICOM” SH.P.K.

VENDIM

I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE

Sot me date 29/06/2024, ora 11:00 në selinë e shoqërisë, në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Tirane, Shqipëri, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Pergjithshme te Ortakëve të shoqërisë “DIGICOM” SH.P.K., për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës si vijon:

1. Miratimi i Pasqyrave Financiare per vitin ushtrimor 2023.
2. Destinimi i rezultatit te vitit ushtrimor 2023.
3. Emerimi i audituesit ligjor per auditimin e pasqyrave financiare per vitin 2024.

Ne mbledhje jane te pranishëm ortaket e shoqërisë:

- **Marin Gjonaj** me 15 % pjesmarrje; shtetas shqiptar, lindur me 30.08.1985, ne Tirane, i biri i Besnikut dhe i Brixhildes, mbajtes i pasaportes me Nr. BB8195890;
- **ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION sh.p.k** me 85% pjesmarrje; me seli ne adresen Nr. 2, Ndërtesa Nr. 12, Rruga "Papa Gjon Pali II -të, Ndërtesa "ABA Business Center" Kati i 19, Zyra Nr. 1901 ,Tirane, Shqipëri, regjistruar si person juridik shqiptar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NIPT me Nr. Identifikimi L01425001U ne daten 25/02/2010, perfaqesuar nga administratori Z. Bardhyl Vidrica;
- Administratori i shoqërisë Z. Thoma Zbogo;

RENDI I DITES:

Çeshtja Nr. 1 Miratimi i Pasqyrave Financiare per vitin ushtrimor 2023.

Ne vijim te diskutimeve, Asambleja e Pergjithshme ne menyre unanime aprovon Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2023, si edhe rezultatit financiar perkates te bilancit, me vlere fitimi prej 30,396,028 Leke. Bilanci vjetor per vitin 2023 dhe Raporti i Audituesit te pavaruar “FILTO Auditing” shpk, i bashkelidhen ketij Vendimi dhe konsiderohen pjese integrale e pandare e tij.

Çeshtja Nr. 2 Destinimi i rezultatit te vitit ushtrimor 2023.

Ne vijim te diskutimeve, Asambleja e Pergjithshme, lidhur me destinimin e rezultatit financiar per vitin 2023, fitim ne vleren prej 30,396,028 leke, ne menyre unanime aprovon:

- Vlera prej 27,148,007 Leke do te mbuloje humbjet e mbartura nga periudhat e meparshme.
- Vlera prej 3,096,624 Leke do te kaloje per shtese kapitali.
- Ndërsa diferenca prej 151,397 Lek do te kaloje ne Rezerva te tjera.




-Fillimin e procedurës për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë si rikapitalizim i fitimit të vitit 2023 dhe caktimin e “FILTO Auditing” shpk, me NUIS K81401002H, për kryerjen e Aktit të Ekspertimit, i cili do të evidentojë rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë “Digicom” shpk.

Çeshtja Nr. 3 Emerimi i audituesit ligjor për vitin 2024.

Ne vijim të diskutimeve, Asambleja e Përgjithshme në mënyrë unanime aprovon caktimin e “FILTO Auditing” shpk, si Auditues Ligjor i Shoqërisë për vitin 2024.

Gjithashtu Asambleja e Përgjithshme në mënyrë unanime aprovon depozitimin e Vendimit të Asamblese së bashku me dokumentat e bashkelidhura (Bilanci dhe Pasqyrat Financiare) pranë Qendres Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” të ndryshuar.

Duke mos patur çeshtje të tjera për diskutim, mbledhja mbyllet dhe proces verbali i mbledhjes u hartua dhe u nënshkrua me vullnetin e lirë dhe të plotë të ortakeve.

**ORTAKET E SHOQËRISE
“DIGICOM” SH.P.K.**


Marin Gjonaj



“ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION” sh.p.k

Perfaqësuar nga Administratori

Bardhyl Vidrica



“DIGICOM” SH.P.K.**VENDIM****I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE**

Sot me date 25/07/2024, ora 12:00 në selinë e shoqërisë, në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë **“DIGICOM” SH.P.K.**, për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës si vijon:

1. Miratimi i raportit të ekspertit kontabel për rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Ne mbledhje janë të pranishëm ortakët e shoqërisë:

- **Marin Gjonaj** me 15 % pjesëmarrje; shtetas shqiptar, lindur me 30.08.1985, në Tiranë, i biri i Besnikut dhe i Brixhildes, mbajtes i pasaportes me Nr. BB8195890;
- **ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION sh.p.k** me 85% pjesëmarrje; me seli në adresën Nr. 2, Ndërtesa Nr. 12, Rruga "Papa Gjon Pali II -të, Ndërtesa "ABA Business Center" Kati i 19, Zyra Nr. 1901 ,Tiranë, Shqipëri, regjistruar si person juridik shqiptar në Qendren Kombëtare të Biznesit me NIPT me Nr. Identifikimi L01425001U në datën 25/02/2010, me administrator Z. Bardhyl Vidrica, përfaqësuar me prokurë nga Z. Halil Sulku;


RENDI I DITES:**Çështja Nr. 1****Miratimi i raportit të audituesit ligjor për rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë**

Asambleja e Përgjithshme pasi prezantohet me Raportin e Audituesit Ligjor, në mënyrë unanime miraton shtimin e kapitalit të Shoqërisë “Digicom” shpk, në vlerën 3,096,624 (Tërë milionë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) Lek.

Kapitali i rregjistruar i Shoqërisë “Digicom” shpk bëhet në vlerë 239,000,000 (Dyqind e tridhjetë e nëntë milionë) Lek, i ndarë sipas ortakëve me kuotat ekzistuese si më poshtë:

	Pjesë	Kapitali ishte	Shtesa	Kapitali i ndryshuar
Marin GJONAJ	15	35,385,506	464,494	35,850,000
ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION	85	200,517,870	2,632,130	203,150,000
	100	235,903,376	3,096,624	239,000,000

Gjithashtu Asambleja në mënyrë unanime aprovon depozitimin e Vendimit të Asamblese së bashku me Raportin për zmadhimin e kapitalit të Audituesit Ligjor pranë Qendres Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” të ndryshuar.





DIGICOM
përtej shpërndarjes

Ketij Vendimi i bashkelidhen, Vendimi me te cilin jane miratuar Pasqyrat Financiare per vitin 2023 dhe raporti i Audituesit Ligjor per zmadhimin e kapitalit.

Duke mos patur ceshtje te tjera per diskutim, mbledhja mbyllet dhe proces verbali i mbledhjes u hartua dhe u nenshkrua me vullnetin e lire dhe te plote te ortakeve.

**ORTAKET E SHOQERISE
"DIGICOM" SH.P.K.**

Marin Gjonaj

"ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION" sh.p.k

Administrator

Bardhyl Vidrica

Perfaqesuar me prokure nga

Halil Sulku

